



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.729/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), me panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Milena Đerić dhe Kymete Kicaj anëtare, duke vendosur përkitazi me apelin e Muharrem Shtavica, kandidat për Kuvend Komunal nga radhët e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Rahovec, të paraqitur kundër Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, me objekt të çështjes manipulim i votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021. në seancën e panelit të mbajtur më datë 03.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

HUDHËN të pa palejuara apelet Anr.729/2021 dhe Anr.730/2021, të datës 02.11.2021, të paraqitura nga Muharrem Shtavica, kandidat për Kuvend Komunal nga radhët e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Rahovec për manipulim të votave në vendvotimet 1610A/01R, 1610A/02R dhe 1610A/03R në fshatin Xërxe në Rahovec, për Zgjedhjet Lokale 2021, të datës 17.10.2021.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 02.11.2021, ka pranuar apelet Anr.729/2021 dhe Anr.730/2021, të dërguara përmes postës me datë 29.10.2021, nga Muharrem Shtavica, kandidat për Kuvend Komunal nga radhët e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Rahovec, me të cilat pretendon se në vendvotimet 1610A/01R, 1610A/02R dhe 1610A/03R në fshatin Xërxe në Rahovec është bërë shkelje ashtu që kandidatit të Lëvizjes Vetëvendosje, Sinan Kryeziu në VV 1610A/01R nga gjithsej 44 vota të listës së Lëvizjes Vetëvendosje i ka marrë 30 vota, në VV 1610A/02R nga gjithsej 34 vota të LVV-së të njëjtit i ka marrë 27 vota si dhe në VV 1610A/03R nga gjithsej 63 vota i ka marrë 42 vota derisa ankuesi ka marrë vetëm 3 vota. Andaj parashtruesi i apelit kërkon që të bëhet rinumërimi i kutive të votimit për shkak të manipulimeve të votave në këto vendvotime.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e apelit, gjeti se:

Apelet janë të palejuara

Paneli bazuar në nenin 13 paragrafi 2 të Rregullave dhe Procedurave Nr.02/2015, të PZAP-it, në të cilën përcaktohet se: *“Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të apeleve kryesuesi i panelit vendimmarrës mund të vendos ta bëjë bashkimin e apeleve që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato apele të trajtohen me një vendim”*, Paneli bëri bashkimin e ankesave dhe për të njëjtat vendosi me një vendim, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve në apele, lidhur me shkeljet e dhe parregullsitë, për faktin se shkeljet që ndërlihen me rezultatin e votimit, duhet të parashtrihen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procesit zgjedhor.

Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ti hudhë si të parakohshme apelet e ankuesit. Hudhja e apeleve të Muharrem Shtavica, kandidat për Kuvend Komunal nga radhët e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Rahovec nuk e paragjykon çështjen dhe apeluesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes apele tjera, pas shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.729/2021 më datën 03.11.2021



Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.*